




Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

KA DËSHTUAR TË HËNËN MBLEDHJA E KRYESISË SË KUVENDIT

OSMANI, BASHËS: EKIPI LIGJOR I PRESIDENCËS PO ANALIZON KONSTITUIMIN E KUVENDIT

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar kryetarin e ri të Kuvendit, Dimal Basha, se ekipi ligjor i Presidencës është duke bërë analizë lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit. Takimi në mes të Osmanit dhe Bashës

është zhvilluar të hënë në Zyrën e Presidencës. Pas më shumë se gjashtë muajsh ngërc politik, deputetët kanë zgjedhur kryetarin e Kuvendit, deputetin Dimal Basha, po procesi ka ngelur te zgjedhja e nënkryetarit të

Kuvendit nga komuniteti serb. Pasi nuk u zgjodh nënkryetari i pestë nga komuniteti serb, Basha ka theksuar të shtunën se janë konsumuar të gjitha opsionet, duke e quajtur të mbyllur seancën konstituive

NIS VITI I RI SHKOLLOR

F. 7



BASHA KËRKON FALJE PËR ARTIKULLIN KUNDËR UÇK-së: KAM QENË I PAKUJDESSHËM

F. 5



AKTUALE



**TRANSPORTUESIT NË BOSNJË
PROTESTOJNË KUNDËR RREGULLAVE
TË BE-së** F. 2

**GËRVALLA: KOSOVA MBETET E
PËRKUSHTUAR NDAJ RRUGËTIMIT
EUROATLANTIK** F. 5

**HAPET FUSHATA PËR RRRITJEN E
VETËDIJESIMIT RRETH RREZIKUT
TË PËRDORIMIT TË SUBSTANCAVE
NARKOTIKE NGA FËMIJËT DHE
TË RINJTË** F. 6

EKONOMI



**RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT NË
KOSOVË NË TREMUJORIN E DYTË
TË 2025-s** F. 8

**MBI TRE MILIONË TË PAPUNË NË
GJERMANI, REKORD NË DEKADËN
E FUNDIT** F. 8

SPORT



**FODA: JETOJMË PËR FUTBOLLIN,
SYNOJMË TA REALIZOJMË ËNDRRËN
E BOTËRORIT** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Transportuesit në Bosnjë protestojnë kundër rregullave të BE-së

SARAJEVË, 1 SHTATOR - Mijëra shoferë të kamionëve në Bosnjë kanë ndërprerë dërgesat në mbarë vendin të hënën, më 1 shtator, duke kërcënuar se do t'i bllokojnë mallrat derisa kërkesat e tyre, për kushte më fleksibile të udhëtimeve dhe mbështetje më të madhe brenda Bashkimit Evropian, të plotësohen. Rreth 6 000 shoferë kamionësh ndalën pothuajse krejtësisht transportin e mallrave, duke shkaktuar kolona në trafik. Shoferët po kërkojnë kushte më të mira pune në tregun kryesor të eksportit të vendit në BE. Sipas shifrave zyrtare, vitin e kaluar BE-ja përbënte rreth 64 për qind të tregtisë së huaj të Bosnjës. Mbi 90 për qind të mallrave

transportohen përmes transportit rrugor. "Ne kemi ndaluar zinxhirët tanë të furnizimit përmes Bosnjë-Hercegovinës", tha Velibor Peuliq nga Asociacioni i Shoferëve të Kamionit në Bosnjë, Konzorcijum logistika BiH. Ky asociacion ka penguar që rreth 4 000 tonë mallra të shkonin në kryeqytet, Sarajevë, tha Peuliq. Për muaj të tërë, përfaqësuesit i këtij sektori, i cili ka ndërmjet 15 mijë deri në 18 mijë shoferë, kanë kërkuar nga autoritetet të negociojnë me BE-në për ndryshimin e një rregulli që ata e quajnë "diskriminues" ndaj tyre. Qëndrimi i tyre në bllokun evropian, ku Bosnja synon të anëtarësohet, është i kufizuar në 90 ditë brenda një periudhe 180-

ditore - afat që vlen edhe për turistët. Kjo rregull daton që nga viti 2008, kur Bosnja nënshkroi një marrëveshje tregtare me BE-në. Shoferët kërkojnë një përjashtim nga rregulli i 90 ditëve ose që vizitat e tyre të maten në orë, në vend të ditëve. "Pasi zinxhirët e furnizimit të ndalen, kjo do të jetë e dukshme në çdo qytet... Shpresojmë që ministrinë të nisin ta bëjnë punën e tyre që nga sot", deklaroi Peuliq. Rreth 10 pika kufitare janë bllokuar përmes vendosjes së kamionëve dhe shumica e kamionëve janë vendosur në kufi me Kroacinë, sipas klubit automobilistik BIHAMK. Edhe pse qëllimi i shoferëve të



kamionëve nuk ishte ta bllokonin trafikun rrugor, veprimi i tyre ka shkaktuar vonesa të mëdha në

hyrjet e disa qyteteve, përfshirë kryeqytetin e Bosnjës, Sarajevë, tha BIHAMK.

Putini thotë se kishte "pajtim" me Trumpin për përfundimin e luftës në Ukrainë

MOSKË, 1 SHTATOR - Presidenti rus Vladimir Putin tha se ka pasur "pajtim" me presidentin amerikan Donald Trump për përfundimin e luftës në Ukrainë gjatë takimit të tyre në Alaskë muajin e kaluar. Megjithatë, ai nuk tha nëse do t'i pranonte bisedimet e paqes me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky të ndërmjetësuar nga Trumpi. Duke folur gjatë një samiti në Kinë, Putini vazhdoi ta mbronte vendimin e tij për ta pushtuar Ukrainën dhe fajësoi edhe një herë Perëndimin për luftën. Pas takimit në Alaskë muajin e kaluar, i dërguari i posaçëm i ShBA-së, Steve Witkoff, tha se Putini ka rënë dakord për garancitë e sigurisë për Ukrainën - si pjesë e një marrëveshjeje të mundshme



për paqe në të ardhmen - megjithëse Moska nuk e ka konfirmuar ende këtë. Putini foli në samitin e Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait, ku u takua me udhëheqësin e Kinës, Xi Jinping, dhe atë të Indisë,

Narendra Modi. Ai i falënderoi ata për mbështetjen e tyre dhe për, siç tha, përpjekjet "për ta lehtësuar zgjidhjen e krizës në Ukrainë". Kina dhe Rusia janë blerëset më të mëdha të naftës së papërpunuar ruse, ndaj edhe

kritikohen nga Perëndimi për mbështetje të ekonomisë ruse. Në fjalimin e tij, Putini tha se shpreson se "pajtimet e arritura" në takimin e tij me Trumpin në Alaskë, janë "duke ecur në këtë drejtim, duke hapur rrugë për paqe në Ukrainë". Në të njëjtën kohë, ai përsëriti qëndrimin se "kjo krizë nuk është shkaktuar nga sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës, por ishte rezultat i një grushtshteti në Ukrainë, i cili u mbështet dhe u provokua nga Perëndimi". Ai, po ashtu, ua atribuoi luftën "përpjekjeve të vazhdueshme të Perëndimit për ta tërhequr Ukrainën në NATO". Putini e ka kundërshtuar vazhdimisht mundësinë e anëtarësimit të Ukrainës në NATO.

Të premten presidenti francez Emmanuel Macron tha se Trumpi i ka dhënë atij afat deri të hënën për t'i pranuar bisedimet e paqes me Zelenskyn. "Nëse nuk pranon, kjo tregon se Putini e ka manipuluar sërish Trumpin", tha Macroni. Megjithatë, më 22 gusht Trumpi i tha CNN-it se po i jepte Putinit "disa javë" kohë për t'u përgjigjur. Pas takimit me Putinin muajin e kaluar, Trumpi kërkoj një marrëveshje të përhershme paqeje. Ai takoi edhe presidentin ukrainas Zelensky dhe udhëheqës të lartë evropianë dhe theksoi se pjesë e marrëveshjes nuk do të ishte anëtarësimi i Ukrainës në NATO. Ai sugjeroi se do të kishte garanci sigurie për Ukrainën dhe se ShBA-ja do të ishte e përfshirë në to.

Ndërhyrje e dyshuar ruse në sistemin GPS gjatë uljes së avionit të Von der Leyenit në Bullgari

BRUKSEL, 1 SHTATOR - Autoritetet bullgare kanë njoftuar se sistemet e navigimit GPS në Aeroportin e Plovdivit u goditën nga një sulm i dyshuar i ndërhyrjes ruse, duke "neutralizuar" kontaktin me avionin e presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, teksa ai po afrohej për t'u ulur në tokë gjatë fundjavës. Qeveria në Sofje, përmes një deklarate më 1 shtator, tha se kulla e kontrollit në aeroport humbi sinjalin GPS të avionit, i cili, megjithatë, u ul në mënyrë të sigurt, duke përdorur sistemet tokësore të

navigimit, të pavarura nga GPS-i. "Ka pasur një neutralizim të sinjalit satelitor që furnizon me informata sistemin e navigimit GPS të avionit. Gjatë afrimit për ulje në Aeroportin e Plovdivit, sinjali GPS është zhdukur", thuhej në deklaratë. Zyrtarë të BE-së e kanë konfirmuar incidentin e 31 gushtit, duke thënë se "kemi marrë informata nga autoritetet bullgare se dyshohet se bëhet fjalë për ndërhyrje të hapur nga Rusia". "Ne, sigurisht, jemi të vetëdijshëm dhe tashmë të mësuar me kërcënimet dhe frikësimet të cilat janë pjesë e



rregullt e sjelljes armiqësore të Rusisë", tha zëdhënësja e Komisionit Evropian, Arianna

Podesta. Zyrtarët rusë nuk kanë komentuar publikisht mbi

akuzat. Von der Leyen, e njohur për kritikën e saj të ashpër ndaj presidentit rus Vladimir Putin dhe pushtimit të Ukrainës, ndodhet në një turne katërditor në vendet e Bashkimit Evropian, që kufizohen me Rusinë dhe Bjellorusinë, aleatën më të afërt të Kremlinit. Podesta shtoi se incidenti "nënvizon urgjencën e misionit që presidentja po zhvillon në shtetet anëtare të vijës së parë". "Natyrshet, kjo do ta forcojë edhe më tej përkushtimin tonë të palëkundur për t'i rritur kapacitetet mbrojtëse dhe mbështetjen për Ukrainën", theksoi ajo.

NIS VITI I RI SHKOLLOR

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Të hënën në Kosovë ka filluar viti i ri shkollor 2025-2026. Me këtë rast përfaqësuesit e institucioneve qendrore, ata lokalë dhe liderët e partive politike, kanë uruar për një vit të mbarë shkollor. Ministrja në detyrë e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka uruar nxënësit, mësuesit dhe prindërit për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026, duke theksuar rëndësinë e dijes dhe bashkëpunimit për sukses. Në një mesazh të publikuar në rrjetet sociale, Nagavci e ka cilësuar këtë moment si një udhëtim i ri i dijes, ku sfidat dhe mundësitë e reja presin të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor. “Sot nis një udhëtim i ri i dijes, i mbushur me sfida dhe mundësi të reja për të gjithë nxënësit, mësuesit dhe prindërit tanë. Ky është momenti kur fëmijët kthehen me buzëqeshje në bankat shkollore, të etur për të mësuar,

për t’u rritur dhe për të realizuar ëndrrat e tyre”, ka shkruar ministrja në detyrë. Ajo ka theksuar se arsimi është çelësi për një të ardhme më të ndritur dhe të qëndrueshme për Kosovën dhe ka bërë thirrje për krijimin e një ambienti mbështetës dhe frymëzues për nxënësit. “Uroj që ta nisni këtë vit shkollor me energji pozitive, përkushtim dhe shpresë, duke besuar fort në fuqinë e dijes suaj”, ka shtuar Nagavci. Ministrja është shprehur e bindur se me bashkëpunimin e shkollave, prindërve dhe mësimdhënësve, sukseset në arsim nuk do të mungojnë. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka uruar të gjithë nxënësit, mësimdhënësit me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor. Në një mesazh të publikuar në rrjetet sociale ajo thekson rëndësinë e këtij momenti si një fillim i ri, i mbushur me mundësi për zhvillim, dije dhe sukses. “1 shtatori gjithmonë

sjell me vete frymën e një fillimi të ri, ku secili nxënës, mësues dhe prind ka mundësinë ta shkruajë histori të suksesit. Le të hyjmë në këtë vit shkollor me kurajë, me besim dhe me respekt për njëri-tjetrin”, ka shkruar Osmani. Ajo ka bërë thirrje që nxënësit të mos ndalojnë së pyeturi e kërkuari, ndërsa mësuesit të mos kursejnë nga angazhimi për përgatitjen e brezave të ardhshëm. “Urime fillimi i vitit të ri shkollor! Qoftë një vit i mbushur me dije, gëzim dhe suksese për të gjithë!”, ka përfunduar Osmani. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor ka uruar të gjithë nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit në Republikën e Kosovës. “1 Shtatori shënon një ditë të veçantë, sepse është dita kur shkollat hapin dyert për brezat e rinj, të gatshëm për të mësuar dhe për të ndërtuar të ardhmen. Shkolla nuk është vetëm vendi i dijes, por edhe hapësira ku

mësohen vlerat, ku forcohet karakteri, ku kultivohet dashuria për atdheun dhe ku formohen qytetarët e përgjegjshëm të së ardhmes. Mirënjohje të thellë për mësuesit dhe edukatorët, që me përkushtim e dashuri udhëheqin fëmijët tanë drejt diturisë dhe që me shembullin e tyre ndriçojnë rrugën e brezave të rinj. Urime të gjithë nxënësve, prindërve dhe mësuesve për një vit shkollor të mbushur me suksese, frymëzim dhe arritje të reja!”, ka thënë Basha në urimin e tij. Edhe kryeministri në detyrë ka uruar për fillimin e vitit shkollor. Ai së bashku me ministren në detyrë të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, vizituan nxënësit e klasës I/1 të shkollës ‘Hasan Prishtina’ në Prishtinë. “Dita e parë e klasës së parë është një ditë e veçantë për çdo fëmijë dhe çdo prind. Këtë vit shkollor, në nivel vendi janë afër 25 mijë fëmijë që nisin mësimet në klasën e parë, që takojnë

mësueset e mësuesit e tyre dhe që fillojnë miqësitë e para me shokët e shoqet e klasës dhe gjeneratës. Bashkë me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, vizituan nxënësit e klasës I/1 të shkollës ‘Hasan Prishtina’ në Prishtinë, me mësuese Drita Bashota, dhe i uruam për zemërsisht fillim të mbarë e rrugëtim të suksesshëm përgjatë gjithë shkollimit. I inkurajoj të gjithë mësimdhënësit që të jenë sa më afër fëmijëve dhe nxënësve, sepse në moshat e hershme dashuria e mësuesit dhe mësueses është jo më pak e vlefshme sesa ajo e prindërve. Dashamirësia që tregojmë për të tjerët dhe për ta bëhet faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin dhe edukimin e tyre. Urime fillimi i vitit të ri shkollor 2025/2026!”, ka shkruar Kurti në “Facebook”. Për fillimin e vitit të ri shkollor, nxënësit, mësuesit dhe prindërit i kanë uruar edhe liderët e partive politike.



BASHA KËRKON FALJE PËR ARTIKULLIN KUNDËR UÇK-së: KAM QENË I PAKUJDESSHËM

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, ka deklaruar të hënën pas mbledhjes së Kryesisë se Kuvendit, ka folur lidhur me artikullin akademik në të cilin përmendet Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ai ka kërkuar falje duke e quajtur “pakuja” pjesëmarrjen e tij në punim dhe ka theksuar se ka kërkuar që kapitulli i shkruar prej tij të hiqet, bashkë me emrin e tij si autor. “Kërkoj falje për pakuja të time. Duhet ta pranoj që kam qenë i pakujdesshëm dhe i pavëmendshëm. Unë kam kërkuar që të tërhiqet kapitulli




dhe emri im nga punimi. Unë nuk kam të bëjë me pjesën tjetër asgjë. Unë kam dërguar emalin, ku kam kërkuar që të tërhiqet emri dhe kapitulli im. Unë kërkoj falje për pavëmendjen time, por askush nuk mund ta vë në dilemë atdhetarizmin tim”, ka thënë ai. Ai në fund shtoi se UÇK është vlera më e çmueshme. “Nuk e gjeni asnjë fjalë të vetme që ka dalë ndaj vlerës më të madhe e më të shenjtë që ka kjo republikë e që është UCK për shkak se ushtria nuk i takon asnjë subjekti, asnjë njeriu, i takon popullit tonë dhe nuk ka vlerë më të çmueshme se ajo”, tha ai.

OVLUÇK-ja nuk pranon kërkimfaljen e Dimal Bashës: Qëndrimi ynë mbetet i qartë

Organizatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë reaguar ndaj kryetarit të Kuvendit, Dimal Basha, duke thënë se kërkimfalja e tij publike nuk është e mjaftueshme. Në reagimin e tyre thuhet se qëndrimet e Bashës, të shprehura në një punim shkencor të vitit 2012, cenojnë luftën çlirimtare dhe UÇK-në,

duke rënë ndesh me betimin kushtetues që ai ka dhënë si deputet dhe kryetar i Kuvendit. “Respekti ndaj themeleve të shtetit tonë, të ngritura mbi sakrificën e Dëshmorëve dhe Luftëtarëve të lirisë, është i panegociueshëm. Për këtë arsye, Dimal Basha duhet të shkarkohet menjëherë nga posti i kryetarit të Kuvendit”, thuhet në reagim. Organizatat njoftuan se tashmë u kanë dërguar një kërkesë zyrtare deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke kërkuar nisjen e procedurës për shkarkimin e Bashës dhe janë në pritje të veprimeve të tyre.



KA DËSHTUAR TË HËNËN MBLEDHJA E KRYESISË SË KUVENDIT

OSMANI, BASHËS: EKIPI LIGJOR I PRESIDENCËS PO ANALIZON KONSTITUIMIN E KUVENDIT

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar kryetarin e ri të Kuvendit, Dimal Basha, se ekipi ligjor i Presidencës është duke bërë analizë lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit. Takimi në mes të Osmanit dhe Bashës është zhvilluar të hënën në Zyrën e Presidencës. Pas më shumë se gjashtë muajsh ngërç politik, deputetët kanë zgjedhur kryetarin e Kuvendit, deputetin Dimal Basha, po procesi ka ngelur te zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga komuniteti serb. Pasi nuk u zgjodh nënkryetari i pestë nga komuniteti serb, Basha ka theksuar të shtunën se janë konsumuar të gjitha opsionet, duke e quajtur të mbyllur seancën konstituive

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, e thirrur për të hënën nga kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, nuk u mbajt për shkak të mungesës së kuorumit. Të pranishëm, përveç Bashës, ishin dy nënkryetare: Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Emilja Rexhepi nga partitë joserbe, por munguan ata të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Me Rregulloren e Punës së Kuvendit, mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të Kryesisë.

Nënkryetari i pestë nga komuniteti serb nuk është zgjedhur.

Mbledhja e Kryesisë u thirr nga Basha, i cili e shpalli të përfunduar seancën konstituive pa nënkryetarin serb për t'u konsultuar rreth vazhdimit të punës së institucionit. "Për mua nuk ka logjikë që të bllokohet Kuvendi i Republikës për moszgjedhjen e një nënkryetari", përsëriti Basha të hënën.

Në tri vazhdimet e seancës konstituive kandidatët serbë për nënkryetar dështuan t'i sigurojnë votat e nevojshme. Basha e shpalli të mbyllur seancën, me arsyetimin se janë shteruar të gjitha mundësitë. Partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, e mbështeti, ndërsa ish-opozita kundërshtoi.

Duke folur pas dështimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Basha tha se është takuar me

presidenten e vendit, Vjosa Osmani, por nuk dha shumë detaje.

Kuvendi i Republikës së Kosovës publikoi më herët një njoftim, ku thuhej se Basha e ka informuar presidenten për përfundimin e seancës konstituive dhe se të dy kanë diskutuar mbi hapat e mëtejshëm institucionalë, por e tërhoqi pak minuta më vonë.

Basha tha se stafi ka bërë gabim dhe ka shkruar një komunikatë pa miratimin e tij.

"Presidentja nuk ka dhënë mendim. Ajo vetëm se ka dëgjuar arsyetimin tim [për seancën konstituive]", tha Basha për gazetarët.

Në një komunikatë dërguar medieve pas takimit, Osmani tha se e ka informuar Bashën se ekipi ligjor i Presidencës është duke bërë

analizë lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës. "Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur sot në takim, në cilësinë e tij, të kryetarit të sapozgjedhur të Kuvendit të Kosovës, z. Dimal Basha. Në këtë takim, kryetari Basha e ka prezantuar qëndrimin e tij lidhur me konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, presidentja Osmani e ka informuar kryetarin Basha se ekipi ligjor i Presidencës është duke bërë analizën lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës. Presidentja ka potencuar se, sikurse gjithmonë, do të veprojë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, duke garantuar stabilitetin institucional dhe respektimin e vullnetit të qytetarëve të Kosovës", ka njoftuar Presidencia.

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, deklaroi se pas konstituimit të pjesshëm të Kuvendit, hapi i radhës duhet të jetë formimi i qeverisë. Ajo kërkoi mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Përgjithshëm për ta votuar mandatarin. "Na duhet mbledhje

e Këshillit të Përgjithshëm që ta votojmë mandatarin, e pastaj Arbërie Nagavci ta dërgojë emrin e kryeministrit Kurti te presidentja Osmani", tha Haxhiu.

Haxhiu kritikoi opozitën për mungesë të bashkëpunimit, duke e cilësuar të papranueshme mospërkrahjen për Nenad Rashiqin si nënkryetar i Kuvendit. "Është për të ardhur keq që nga 52 deputetë të opozitës, as edhe 4-5 vota për të përkratur Nenad Rashiqin", u shpreh nënkryetarja e Kuvendit. Ajo tha se Rashiqi nuk duhet të barazohet me Listën Serbe: "Z. Rashiqi nuk mund të futet në të njëjtin thes me Listën Serbe, sepse kryetari formal i saj ka kryer sulm terrorist në Republikën e Kosovës", u shpreh Haxhiu.

Në fund Haxhiu u shpreh se mazhoranca nuk do të lejojë që institucionet të mbesin të bllokuara. "Ne nuk do të lejojmë që pakicat ta bllokojnë funksionimin e institucioneve. Koha e lojërave e pazareve ka përfunduar", tha ajo.

Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka theksuar se pas qeverisë, edhe Kuvendi i Kosovës nis funksionimin jokushtetues. "Me mbajtjen e mbledhjes së sotme të

KUSHTETUESJA KONFIRMON SE KA PRANUAR KËRKESËN E LISTËS SERBE, POR NUK JEP HOLLËSI

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konfirmuar për “KosovaPress” se kërkesa e përfaqësuesve të Listës Serbe është dorëzuar të shtunën në mënyrë elektronike në gjykatë. Megjithatë, nuk është përgjigjur nëse ajo kërkesë konsiderohet e ligjshme. Zëdhënësi i Gjykatës Kushtetuese, Veton Dula, ka konfirmuar se gjykata ka pranuar këtë kërkesë më 30 gusht. Duke u bazuar se deputetët e Listës Serbe nuk njohin as Kuvendin e Kosovës, të cilit së fundmi gjatë deklaratave iu kanë referuar si Kuvendi i

Prishtinës, “KosovaPress” ka pyetur Gjykatën Kushtetuese se si iu ka referuar Lista Serbe këtij institucioni, por Kushtetuesja nuk është përgjigjur as për këtë çështje. Lista Serbe njoftoi të shtunën se është ankuar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës kundër votimit, ndaras për zgjedhjen e nënkryetarëve nga komunitetet pakicë gjatë seancës konstituive. Lista Serbe njoftoi në “Facebook” se deputetët e saj dorëzuan të hënën një ankesë në Gjykatën Kushtetuese “për shkak të shkeljes së rëndë të të drejtave të popullit serb në

seancat e kuvendit në Prishtinë”. Ajo tha se pret nga gjykata “të reagojë menjëherë dhe t’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e sundimit të ligjit, si dhe të drejtave të popullit serb në përputhje me aktet juridike në fuqi”. Ankesa e partisë së serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar erdhi pasi kryetari i porsazgjedhur i Kuvendit, Dimal Basha, i hodhi në votim ndaras nënkryetarët e pakicave dhe më pas përdori shortin për kandidatët për nënkryetarin serb.



GËRVALLA: KOSOVA MBETET E PËRKUSHTUAR NDAJ RRUGËTIMIT EUROATLANTIK



PRISHTINË, 1 SHTATOR - Me ftesë të zëvendëskryeminstres dhe ministres së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Sllovenisë, Tanja Fajon, zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, po merr pjesë në edicionin e 20 jubilar të Forumit Strategjik të Bledit, që mbahet më 1 dhe 2 shtator 2025, me temën “Një botë e pakontrolluar” (A Runaway World). Forumi i Bledit mbetet një platformë e rëndësishme globale për debatin rreth sfidave të sigurisë, zhvillimit dhe

bashkëpunimit ndërkombëtar. Në kuadër të tij, ministria Gërvalla do të jetë folëse në një nga sesionet qendrore, ku do ta paraqesë vizionin e Republikës së Kosovës për forcimin e multilateralizmit dhe ndërtimin e besimit në një kohë të pasigurt globale. Në fjalën e saj ajo do t’i theksojë arritjet e Kosovës në proceset euroatlantike, përparimin në sundimin e ligjit dhe zhvillimin demokratik e ekonomik, duke e pozicionuar Kosovën si një partner i besueshëm dhe aktiv në arenën ndërkombëtare. Gjatë forumit ministria Gërvalla do të zhvillojë takime dypalëshe

me homologë të vendeve pjesëmarrëse, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe aktorë të shoqërisë civile, me synim forcimin e marrëdhënieve diplomatike dhe avancimin e interesave të Republikës së Kosovës. “Kosova, si një demokraci e re në Ballkan dhe Evropë, mbetet e përkushtuar dhe forcojë pozitën e saj ndërkombëtare dhe të ecë përpara në rrugën euroatlantike, duke u mbështetur në dialog, bashkëpunim dhe miqësi të qëndrueshme me aleatët tanë ndërkombëtarë”, ka shkruar Gërvalla në “Facebook”.

IBRAHIMI: KOMUNAT E KOSOVËS HUMBIN MBI 73.5 MILIONË EURO NGA VENDIMET GJYQËSORE VETËM NË VITIN 2025

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim, ka bërë me dije se komunat e vendit po përballen me humbje të mëdha financiare si pasojë e vendimeve gjyqësore, kryesisht për zbatimin e kontratës kolektive. Sipas tij, gjatë vitit 2025 komunave u janë marrë mbi 73.5 milionë euro, të shpërndara në kategori të ndryshme buxhetore: Investime kapitale: mbi 40 milionë euro, mallra dhe shërbime: mbi 24

milionë euro, shpenzime komunale: mbi 3 milionë euro, subvencione dhe transfere: mbi 5.5 milionë euro, kategoritë tjera buxhetore: pjesë nga shuma totale. “Nga kjo shumë komunat kanë mbetur me minus mbi 40 milionë euro vetëm në investime kapitale, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në mosrealizimin e projekteve zhvillimore dhe objektivave të kryetarëve të komunave”, ka deklaruar Ibrahim për “Telegraf”-in. Ibrahim ka theksuar se barrën

më të madhe e përbën zbatimi i kontratës kolektive, ndërsa niveli qendror nuk ka ndërmarrë hapa konkretë për të gjetur një zgjidhje institucionale. Në total, që nga viti 2022 e deri më sot, komunave të Kosovës u janë marrë mbi 236.5 milionë euro përmes vendimeve gjyqësore, duke vënë në rrezik financat lokale dhe duke pamundësuar investime të reja, shërbime më cilësore dhe mbështetje për qytetarët përmes subvencioneve dhe transfereve.



Kryesisë së Kuvendit, në mungesë të një nënkryetari, edhe Kuvendi i Kosovës nis funksionimin jokushtetues. Dy aktgjykimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese dhe vetë Kushtetuta specifikojnë se Kuvendi i Kosovës konstituohet kur zgjidhet kryetari dhe nënkryetarët, duke mos lënë hapësirë interpretimi nëse ndonjëri nga nënkryetarët e Kuvendit nuk zgjidhet. Ndërkaq,

Qeveria e Kosovës në detyrë është duke funksionuar në mënyrë jokushtetuese që nga certifikimi i zgjedhjeve nga ana e KQZ-së, pasi anëtarët e qeverisë që janë certifikuar si deputetë nuk mund të ushtrojnë poste ministrore. Ky nuk është opinion, por fakt, sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të datës 26 qershor 2025, i cili mbi këtë arsyezim e shpalli të paligjshëm

një udhëzim administrativ të ministrit të Financave”, ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se manovrat politike jokushtetuese të një partie anarkike do të na kushtojnë. “Do të na kushtojë edhe fakti se kemi një presidente që nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë në krye të detyrës. Kushtetuta e obligon atë ta sigurojë funksionimin kushtetues të institucioneve të

vendit. Jo vetëm që nuk e kryen këtë obligim, por ajo i lë edhe institucionet e tjera pa bartës, siç është rasti me mosëmërimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Që nga data 26 qershor 2025, kur doli vendimi i Gjykatës Supreme, asnjë fjalë nuk e ka thënë. As tani, kur Kuvendi i Kosovës po nis funksionimin jokushtetues, nuk e dëgjojmë të thotë një fjalë”, ka deklaruar të hënën Hoti.

Që nga 15 prilli janë bërë dhjetëra përpjekje për konstituimin e plotë të Kuvendit, por pa sukses, për shkak të mosmarrëveshjeve politike. Çështja ka përfunduar edhe në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka nxjerrë dy aktgjykime me afate dhe udhëzime për mënyrën e zhvillimit të procesit. Afati i parë nuk u respektua, ndërsa i dyti përfundon më 18 shtator.

Ismaili shpalos pesë zgjidhjet për Prishtinën, nga zhblokimi i trafikut te pezullimi i lejeve ndërtimore

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka paraqitur pesë zgjidhjet e tij kryesore të cilat, sipas tij, do ta ndalin kaosin që ka përfshirë kryeqytetin vitet e fundit. “Jeta në Prishtinë sot është më e vështirë se që ka qenë ndonjëherë. Me qeverisjen e fundit, Prishtina ka përjetuar veç eksperimente të dështuara. Këto janë pesë zgjidhjet e mia kryesore për Prishtinën”, u shpreh ai. Pesë zgjidhjet që Ismaili prezantoi janë: Zhblokimi i trafikut për 18 muaj, me 100

autobusë të rinj, 60 semaforë shtesë, 5 parkingje në hyrjet kryesore dhe një qendër digjitale për menaxhim të trafikut. Qytet i pastër 24/7, me 60 kamionë të rinj për mbeturina, 2 100 kontejnerë në çdo lagje dhe depo speciale për mbeturina voluminoze e ndërtimore. Prej betonit te komuniteti, me pezullimin e lejeve të reja të ndërtimit për 6 muaj, mbjelljen e 100 mijë drunjve dhe qasje në park jo më larg se 300 metra nga çdo shtëpi. Hapja e sheshit

“Xhorxh Bush” në javën e parë, duke krijuar kushte për këmbësorë dhe vetura. Rrugë të sigurta, me ndriçim në 1 000 rrugë shtesë, 450 km trotuare të reja, trajtim human të 5 000 qenve endacakë dhe 200 oficerë sigurie në shkollat e Prishtinës. “Programi ynë e bën Prishtinën qytet me të cilin krenohemi”, përfundoi Ismaili. Ai ka ftuar qytetarët ta vizitojnë www.kohaperprishtinen.com për ta parë platformën e plotë të zgjidhjeve dhe për t’iu bashkuar ekipit të tij për një Prishtinë funksionale dhe të jetueshme.



HAPET FUSHATA PËR RRITJEN E VETËDIJESIMIT RRETH RREZIKUT TË PËRDORIMIT TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE NGA FËMIJËT DHE TË RINJTË

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve, Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit, Trust Circle Foundation dhe organizata Labyrinth, kanë bërë hapjen e fushatës “Një komunitet pa varësi”, fushatë e cila synon rritjen e vetëdijesimit rreth rrezikut të përdorimit të substancave narkotike nga fëmijët dhe të rinjtë. Fushata u hap në sheshin “Ibrahim Rugova” në Prishtinë, ku është vendosur një instalacion ilustrues. Fushata ka për qëllim vetëdijesimin dhe informimin për rritjen e përpjekjeve të



përbashkëta për t’i ndërgjegjësuar qytetarët dhe për ta parandaluar përdorimin e substancave narkotike te fëmijët dhe të rinjtë. Me rastin e hapjes së fushatës,

fjalë rasti mbajtën Donjeta Kelmendi nga KOMF, Krenar Batusha nga Trust Circle Foundation, Adelina Sahirt nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale komuna e Prishtinës dhe Safet

Blakaj nga Qendra Labyrinth. Fushata do të zgjasë dy muaj dhe do të ketë aktivitete të shumta në nivel nacional, në komuna, shkolla dhe komunitet. “Kosova po përballët me sfida të shumta në parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve viktime të abuzimit me substanca narkotike. Vitet e fundit, vlerësohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve ka kaluar për herë të parë shifrën prej 30,000. Brenda kësaj shifre, fëmijët dhe adoleshentët zënë një pjesë gjithnjë e më të madhe, çdo vit e më shumë. Bazuar në të dhënat e organizatës Labyrinth, moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogave ka rënë nga 18 vjeç në vitin 2018, në 16 vjeç në periudhën e fundit”, ka

njoftuar KOMF-i, duke theksuar se për ta adresuar këtë situatë alarmante është thelbësore që të ndërmerren masa urgjente për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e përdorimit të drogave. “Gjithashtu, kërkohet zhvillimi i programeve të strukturuar për parandalimin dhe trajtimin e varësisë nga substancat narkotike në Kosovë dhe zhvillimin e shërbimeve të specializuara për trajtimin e fëmijëve dhe të rinjve përdorues të drogave, si dhe për fuqizimin e prindërve përmes programeve që i ndihmojnë ata të rrisin kapacitetin për përkujdesje dhe mbështetje ndaj fëmijëve të tyre”, është theksuar në njoftimin e KOMF-it.

DREJTORIA RAJONALE E POLICISË GJILAN, PLAN OPERACIONAL PËR VITIN E RI SHKOLLOR 2025 - 2026

GJILAN, 1 SHTATOR - Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2025-2026, ka ndërmarrë një sërë masash ligjore për ta garantuar rendin, me qëllim zhvillimin normal të procesit mësimor në shkolla dhe sigurinë në trafik afër shkollave. Në kuadër të këtyre masave ka hartuar planin operacional “Fillimi i vitit të ri shkollor dhe Siguria në shkolla për vitin 2025-2026”, plan i cili parashikon hapa konkret për të garantuar

një mjedis të sigurt për të gjithë nxënësit, mësimmësuesit dhe stafin e shkollës, duke përfshirë bashkëpunimin e policisë dhe angazhimin e komunitetit shkollor. Me këtë rast është planifikuar që në të gjitha shkollat dhe përreth ambienteve të tyre të ketë prani të shtuar të policisë me qëllim parandalimin e çdo rasti, por edhe parandalimin e aksidenteve të mundshme. Nga njësitet e policisë në komunitet në kuadër të të gjitha



stacioneve policore në nivel të Drejtorisë rajonale të Policisë Gjilan është vendosur

bashkëpunim me autoritetet edukativo-arsimorë si në nivel të drejtorive komunale të arsimit,

drejtorive të shkollave, këshillave të prindërve dhe këshillave të nxënësve duke përcaktuar masa të përbashkëta në implementim të projekteve e fushata vetëdijesuese me qëllim të parandalimit të dukurive negative dhe rritjes së nivelit të sigurisë në ambientet shkollorë. Njësi të policisë në komunitet në kuadër të stacionit policor në Gjilan, me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve, ka shpërndarë fletëpalosje me moton “Lëvizni sigurt në trafik”.

Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadorja e re e Finlandës në Kosovë

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pranuar të hënën letrat kredenciale nga ambasadorja e re e Republikës së Finlandës në Kosovë, Eevamari Laaksonen. Me këtë rast, presidentja e uroi ambasadorën për detyrën e re dhe shprehu bindjen se gjatë mandatit të saj marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve do të thellohen edhe

më tej. Osmani e vlerësoi Finlandën si partnere e rëndësishme e Kosovës, duke ritheksuar mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që ky shtet i ka dhënë rrugëtimit euroatlantik të vendit tonë. Në këtë frymë, presidentja rikujtoi vizitën e saj zyrtare në Finlandë, të cilën e cilësoi si një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet bilaterale dhe si dëshmi

konkrete të miqësisë dhe respektit të ndërsjellë ndërmjet dy vendeve, duke nënvizuar përkushtimin për forcimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët. Gjatë takimit u diskutua gjithashtu mbi zhvillimet e fundit në Kosovë si dhe mbi mundësitë për thellimin e mëtejshëm të partneritetit ndërmjet Kosovës dhe Finlandës.



KOSOVA NË RREZIK... PREJ INJORANCËS!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kush do të luftojë: Qytetarët e Kosovës qe pesë vite po përballen me rrezikun e luftës me Serbinë. Këtë tregim e përsërisin dhe stërpërsërisin ata që as personalisht e as familjarisht nuk e kanë shkrepur një pordhë e lëre më ndonjë plumb për Kosovën apo shqiptarinë! Për ta liria ka pasur kuptim sa Kosova ishte nën okupim të Jugosllavisë dhe Serbisë, liria sot në Kosovë u shërben për të vjedhur pa asnjë përgjegjësi, për të luftuar këtë liri duke mohuar çlirimtarët e vërtetë dhe duke kthyer në qeverisje mendësinë e të nënshtruarit dhe antikombëtarit. Askush deri më sot nuk i ka përndjekur dhe linçuar ish të burgosurit politikë shqiptarë dhe ushtarët e UÇK-së se që e bënë regjimi aktual. Sjellje më antikombëtare dhe më polarizuese nuk mbahet mend të ketë pasur më herët në Kosovë. Aktualisht nuk ka asnjë rrezik që Serbia ta sulmojë Kosovën pasi këtu janë vendosur forcat ndërkombëtare, forcat ushtarake të NATO-s. Këtë e kanë të qartë edhe deputeti Kurthi që kundërligjshëm e mbanë edhe postin e KM sikur edhe presidentja e Ukrainës dhe, kur duhet ta vizitojë ecurinë e punëve të “vargut të shtëpive për banim” në Lagjen e Varfanjakëve në Marigona Hill, edhe e Kosovës, Vojsa Osmani. Vojsa Osmani, si stratege e shquar ushtarake do të angazhohet edhe në luftë kundër karteleve të drogës në Amerikën e Jugut, me mision special ta fshijë nga faqja e dheut kartelin e Sinaloas që paraqet aq shumë rrezik për sigurinë e Kosovës, integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë. Gjithashtu, ka kërkuar nga Tramp që Vojsa Osmani personalisht të merret me Nikolas Maduron, Albin Kurthin e Venezuelës, në aspektin ideologjik. Rreziku i sulmit nga Serbia bëhet real vetëm nëse bashkësia ndërkombëtare e lejon në heshtje këtë në emër të mbrojtjes së të drejtave të serbëve në veri të Kosovës. Ose nëse

Tramp e futë në pako bashkë me zgjidhjen e çështjes së Ukrainës. Tramp mund t'i lë Putinin si bakshish Kosovën, pa e lëvizur syrin dy herë. Edhe në këtë rast kjo do të kufizohet në veriu e Kosovës. Thjesht, po e shihni se si po sillen vendimmarrësit koçemëdhën timer Ukrainës dhe Gazën!! Kosovën, aktualisht as që e konsiderojnë problem. Thjesht, hipotetikisht bashkësia ndërkombëtare, në heshtje apo me marrëveshje mund të lejojë forcat serbe të hyjnë në një territor të caktuar pastaj e caktojnë tampon zonën duke kërkuar nga palët që problemet t'i zgjidhin me bisedime. Ec e hyni në luftë me forcat ndërkombëtare. Kështu patën vepruar pas Rambujesë, ushtarët francezë u vendosën mbi urën e lumit Ibër duke e ndarë Mitrovicën në dy pjesë, të veriut dhe të jugut. Pastaj, si planifikim strategjik e pastruan veriu nga shqiptarët duke e krijuar një realitet tjetër etnik. Vetëm 8 muaj pas përfundimit të luftës, në shkurt të vitit 2000 mbi 12.000 shqiptarë dhe joserbë dhunshëm u përzënë nga pjesa veriore e Mitrovicës nga Rojat e Urës dhe xhandarmeria franceze. Duket si konspiracion por ngjarjet kështu u zhvilluan. Këta pordhagjinjtë që po u bien “dauilleve të luftës” të parët do të ikin nga Kosova për faktin se Kosovën e konsiderojnë “atdhe rezervë”. Familjet nuk i kanë këtu, materialisht janë siguruar për 500 vjetët e ardhshëm prandaj nuk kanë asnjë motiv të luftojnë. Kurrë nuk kanë luftuar, as vet e as familjarisht, që nga koha e Car Dushanit e deri më sot. A po besoni se do të luftojë Lal Culla e Cen Mishi, dezertorë të ndyrë, ky Faraoni hajn nga Peja, Bandilli nga Gushavci, stërkeqja gjenetike dhe kombëtare e Boletinit që është tkurrur deri në pec, ekstatitë e Prizrenit, gjigantët në trup, me bothë edhe më gjigante, ata që kanë dorëzuar “dëshmi” kundër UÇK-së në Hagë, trashëgimtarët e personaliteteve dhe familjeve

patriotike që tashmë janë mbërthyer në shtyllën antikombëtare të turpit të dhënë pas lakmisë dhe hedonizmit sikur edhe mbetjet jugosllave dhe serbe që kanë metastazuar në të gjitha institucionet e vendit të lara dhe fituara me shumë vuajtje, djersë dhe gjak. Këta nuk kanë dhënë asgjë për këtë vend prandaj ne aq lehtësi dhe poshtërsi shpërdorojnë sakrificat e të tjerëve. Luftën, nëse ndodhë do ta bëjnë përsëri trashëgimtarët e ish të burgosurve politikë shqiptarë, të të Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës dhe vatrën nga të cilat gjithmonë ka dalë zjarri i lirisë. Një gjë duhet ta kemi të qartë: nuk ka më luftë sikur në vitet 1998 - 1999, tash lufta bëhet ndryshe, fiton ai që ka armatim të fundit e jo ai që ushtarët i bënë mish për top. Këta që nuk e shohin as hundën e lëre më përtej hunde po thonë se e çliruan veriu, e rikthyem sovranitetin, e përzëmë Serbinë, dinarin dhe zgjedhjet serbe në Kosovë, në fakt i krijuan rrethanat dhe kushtet që, me një ndryshim të qëndrimit ndërkombëtar, veriu i Kosovës të del nga kontrolli shumë shpejt. Keni një popullatë krejtësisht jobashkëpunuese, refuzuese dhe kundërshtuese, si do ta integroni?! Me Eden Atiq a Nenad Rashika a? I pari me të kaluar jugosllave dhe serbe, i dyti kurrë nuk do ta dojë Kosovën dhe shqiptarët më shumë se Serbinë dhe serbët. Nuk është normale që të kemi një pritje tjetër. Besnikëria e Atiqit dhe Rashiqit nuk varet nga koka por në çfarë karrige apo posti e kanë ulur prapanicën!

Kryekuvendari, Dimali: Për të zhbllokuar Kuvendin e Kosovës, PDK-ja dhe AAK-ja siguruan votat e mjaftueshme për zgjedhjen e Dimal Bashës, kryetar Kuvendi. Jo se e vlerësojnë. Madje, e konsiderojnë se injorantin më original në armatën e injorantëve të pozitës. Deri këtu krejt është në rregull deri sa doli një informatë se, bashkë me një autore nga Maqedonia e Veriut në vitin 2012

paskan botuar një “hulumtim”, zi e terr për UÇK-në të cilin do ua kishte për lakmi BIA e Serbisë, Gjykata Speciale Raciste në Hagë, Ministria e Drejtësisë dhe vet Dejona Mihali, kjo antikombëtare e mjerë dhe hibride. Pas luftës në Kroaci kur autoritetet u përpoqën të vendosin mbishkrimin e qytetit Vukovar në alfabetin cirilik, veteranët kroatë e bënë hi e pluhur atë nënshkrim, përkundër forcave të shtuara të policisë kroate. Nëse rasti i Dimal Bashës është i vërtetë dhe po të ndodhte në Kroaci paramendojeni se çfarë fati do të kishte, do ta kishin kryqëzuar si Krishtin! Te ne është hapur debati “demokratik”, për dhe kundër, pushteti e mbron me të gjitha mjetet, opozita kërkon dorëheqje demokratike! Realisht, nëse rasti është i vërtetë, Dimali duhet të arrestohet si ata agjentët e BIA-së dhe pastaj të ekstradohet në Maqedoni të Veriut te ajo kolegja hulumtuese apo në Merdare të “vëllezërit” e Mimozës. Deri atëherë, Dimali e konstituon Kuvendin, e zgjedhë qeverinë si dhe presidentin. Superman i shpërfyturuar! Për t'i mbuluar brekët me m.t. i ka shpallur luftë Listës Serbe, Simiqit dhe Radoiçiqit. A paska “vdekur” Mimoza a? Pordhagjia i përherëshëm nga radhët e samurajëve të tredhur të pushtetit botërisht ka premtuar se më parë e prenë pecin se që e voton Sllavko Simiqin dhe LS-në. Sa tragjike aq edhe mallëngjyese!

Dorëheqje për tërheqje: Liburn Aliu dha dorëheqje shkaku i Dimal Bashës. Disi po distancohet nga ai për të mos u mbuluar me turp. Këta, në vitin 2021 e votuan Sllavko Simiqin për nënkryetar Kuvendi me 91 vota, sot nuk e duan. Shumë interesant, ku është dallimi midis 2021 dhe 2025?! Edhe Lal Culla dhe Lenka nuk e duan as LS-në e as Sllavko Simiqin në kryesi të Kuvendit ndonëse Kushtetuta dhe Rregullorja thonë të kundërtën. Dikush fort po luan me Kosovën, fort po punon

kundër Kosovës, kundër Kushtetutës dhe ligjit. E pabesueshme se për pushtet duhet shkatërruar shtet! Lexova diku se Edi Rama mund ta përfshijë Liburn Aliun në kabinetin qeveritar më 11 shtator 2025. Ani, le ta merr vetëm uroj të mos na e merr Hysen Durmishin, na i këputë të dy këmbët dhe duart. Përfundimisht na e mbytë shpresën! Aman Rama, tregohu i mëshirshëm, mos na lë pa Hysenin.

Mercenarizmi në futboll: Futbollin filluan ta shkatërrojnë paratë e oligarkëve rusë, kinezë, mbretërve dhe princërve arabë. Futbollistët i shndërruan në mercenarë, pastaj trajnerët, madje edhe referët. Çdo gjë i kanë nënshtruar interesit material duke korruptuar vullnetin, shpirtin dhe magjinë e futbollit. Fitim për përfitim! U bënë disa ekipe mercenarësh. Fillimisht ishte PSG që më një ekip midis tjerëve kishte Mesin, Nejmarin dhe Mbapen prandaj nuk fitonte asnjë titull përveç kampionatit francez. Me t'u larguar Mesi, Nejmar dhe Mbape, PSG u bë kampion i Evropës. Situatë të njëjtë keni te Reali, Bajerni dhe së fundi te Liverpuli. Prandaj, këto ekipe mund ta kenë fatin e PSG-së nëse nuk dalin nga bataku i mercenarizmit. Ekipet e mia, Barcelona ka probleme me financa andaj është e kufizuar me blerje të mëdha, Arsenali vazhdimisht po dështon në blerje, Borussia e Dortmundit është shndërruar në vasal të Bajernit kurse Juventusit e ka fatin e shokut Zulo, po jeton nga fama e fituar në të kaluarën. Hiç nuk besoj se Arsenali, me këtë trajner, Artetën mund të bëhet kampion. Realisht, nuk ka as ekip. Neve që jemi për Arsenalin, superkompjuteri që tre vjet po na nxjerr kampion. Ose ky superkompjuter është formatizuar nga Arteta, ose po na bënë qejfin. As Borussia. Juventusit arnohet disi. Barcelona diçka do të fitojë. Uroj të mos e kanë fatin e Kuvendit të Kosovës.

Rritet kostoja e ndërtimit në Kosovë në tremujorin e dytë të 2025-s

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e dytë (TM2) 2025. Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0.7 % në TM2 2025 krahasuar me TM1 2025.

Krahasuar TM2 2025 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak TM2 2024, Indeksi i Kostos së Ndërtimit pati rritje për 4 %. Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0,7 % në tremujorin e dytë (TM2) 2025

krahasuar me tremujorin e parë (TM1) 2025. Rritje kishte te: energjia (5,5 %); pagat (2 %); transporti (1,8 %); kostot e tjera (1,3 %); makineritë (1 %) dhe materialet (0,3 %). Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN)

pati rritje për 4 % në tremujorin e dytë (TM2) 2025, krahasuar me tremujorin e dytë (TM2) 2024. Rritje më të madhe kishte te: energjia (26,9 %); pagat (6,7 %); kostot e tjera (3,7 %); materialet (3,5 %); transporti (3,4 %) dhe makineritë (0,7 %).



MBI TRE MILIONË TË PAPUNË NË GJERMANI, REKORD NË DEKADËN E FUNDIT

BERLIN, 1 SHTATOR - Papunësia në Gjermani për herë të parë pas më shumë se dhjetë vjetësh rritet mbi tre milionë njerëz. Numri i të papunëve u rrit në muajin gusht krahasuar me muajin paraprak për 46 mijë, duke arritur në 3.025 milionë. Kjo është 153 mijë më shumë se në gusht 2023, njoftoi Agjencia Federale për Punësim në Nurnberg. Shkalla e papunësisë u rrit në krahasim me korrikun për 0.1 për qind, në 6.4 për qind. Numri i papunëve mbi kufirin prej tre milionësh ishte regjistruar për herë të fundit në shkurt të vitit 2015, shkruan "DW" (në gjuhën kroate). "Tregu i punës vazhdon të jetë i prekur nga stagnimi ekonomik gjatë viteve të fundit", tha drejtoresha e Agjencisë Federale për Punësim, Andrea Nahles dhe shtoi se "megjithatë, po shihen shenjat e para të stabilizimit". Numri i të papunëve zakonisht rritet gjatë verës pasi kompanitë

punësojnë më pak para pushimeve vjetore. Numrat për gushtin ishin të tillë për herë të fundit 15 vjet më parë. "Të pasurit tre milionë papunë është një pasojë e turpshme e refuzimit për të zbatuar reforma gjatë viteve të fundit", tha Rainer Dulger, presidenti i Aleancës së Shoqatave të Punëdhënësve Gjermanë. Ai theksoi se tani nevojitet një valë e vërtetë reformash në vjeshtë. Në krahasim me nivelin kombëtar, shkalla e papunësisë në landet federale Bremen (11.8 për qind) dhe Berlin (10.5 për qind) mbeti më e larta, ndërsa në landet jugore Bavari (4.2 për qind) dhe Baden-Württemberg (4.7 për qind) ishte më e ulët. Agjencia Federale për Punësim përdori të dhënat deri më 13 gusht. Por pavarësisht prej këtyre numrave rekord, Instituti për Kërkimin e Tregut të Punës dhe Profesioneve (IAB) shikon



shenjat e para të përmirësimit. Për barometrin e tregut të punës, ekspertët çdo muaj pyesin të gjitha agjencitë për

punësim për pritshmëritë e tyre për tre muajt e ardhshëm. Në muajin gusht, për herë të parë pas tre vjetësh, ata pritën që

rritja e papunësisë të ndalojë. Sipas këtyre vlerësimeve, punësimi mund të marrë përsëri hov.

KURTI DHE RIZVANOLLI PËRURROJNË PUNIMET NË NDËRTHESAT SOCIALE NË MITROVICË

MITROVICË, 1 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti dhe ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, kanë marrë pjesë në përrurimin e dy ndërtesave sociale në Shipol dhe Desi të Mitrovicës, ku është investuar në rritjen e efikasitetit të energjisë. Në përrurim morën pjesë edhe përfaqësuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Alessandro Bianciardi, nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri dhe drejtori i Departamentit të Operacioneve i Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Petrit Ahmeti. Falë një investimi prej 381 622 eurosh, në këto ndërtesa është kryer izolimi i çatave dhe mureve të



jashtme, ndërrimi i dyerve dhe dritareve, instalimi i sistemeve të ngrohjes efikase, vendosja e interfonisë dhe implementimi i masave për mbrojtje nga zjarri. Këto dy ndërtesa sociale, të ndërtuara në vitet 2003 dhe 2005, strehojnë 39 familje ose gjithsej 173 banorë dhe për shumë vjet kanë qenë pa izolim të duhur, pa dritare efikase dhe pa sisteme adekuate të ngrohjes. Në Shipol ndërtesa sociale e ndërtuar në vitin 2003 do t'i përmirësojë kushtet e jetesës për 18 familje, përfshirë 4 familje të udhëhequra nga gra. Ndërsa në Desi, ndërtesa e vitit 2005 do t'u shërbejë 21 familjeve, mes tyre 4 të udhëhequra nga gra.

Ky projekt është pjesë e një investimi më të madh, prej mbi 6 milionë euro, që përfshin renovimin e 25 ndërtesave sociale në gjithë Kosovën. Projekti është zbatuar nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe është mbështetur financiarisht 90 % nga Bashkimi Evropian dhe 10 % pjesëmarrje komunale. Përveç ndërtesave sociale, në Mitrovicë janë renovuar edhe 9 objekte publike, duke përfshirë: 4 shkolla, 1 çerdhe, 2 ambulanta në Bajgorë dhe Bare, si dhe Qendrën e Kulturës. Këto renovime përmirësojnë ndjeshëm kushtet e jetesës, të edukimit dhe të shërbimeve shëndetësore për mijëra qytetarë.

Rritje e lehtë e prodhimeve bimore dhe blegtorale

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Llogaritë Ekonomike për Bujqësi" për vitin 2024. Në vitin 2024 prodhimet bimore kanë shënuar rritje për 8,5 %

krahasuar me vitin 2023. Rritja në vlerën e prodhimeve bimore mund të shpjegohet kryesisht me rritjen e vlerës së prodhimit të drithërave, bimëve industriale, bimëve foragjere si

dhe perimeve dhe prodhimeve të kopshtit. Prodhimet blegtorale kanë shënuar rritje për 2,9 % në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023. Rritja mund të shpjegohet me

rritjen e vlerës së produkteve blegtorale. Gjithsej prodhimet bimore dhe blegtorale kanë një rritje të lehtë me 6,3 % në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.



ISH-KOLONELI AMERIKAN: DRONËT ME IA DO TA REVOLUCIONARIZOJNË LUFTËN NË UKRAINË

Frank Sobchak, kolonel në pension i ushtrisë amerikane dhe profesor në Kolejin e Marinës amerikane, tha se përdorimi i dronëve ka krijuar një ngërc që i ngjan Luftës së Parë Botërore.

Radio Evropa e Lirë: *Le të fillojmë me mendimin tuaj për ofensivën ruse në Ukrainë, që duket të jetë shumë më mirë sesa shumë prishin. Cili është realiteti në fushëbetejë?*

Frank Sobchak: Mendoj se kjo është pjesë e një pyetje më të gjerë se ku qëndron konflikti. Në shumë mënyra i ngjan një lufte statike të stilit të Luftës së Parë Botërore: Rusia po korr fitore të vogla, graduale, ndonjëherë vetëm një kilometër katror në ditë. Sipas Institutit për Studim të Luftës, nëse Rusia vazhdon të përparojë me këtë ritëm, do t'i duheshin 300 vjet për ta pushtuar Ukrainën.

Radio Evropa e Lirë: *Por, ritmi është përshpejtuar javëve të fundit. Situata është bërë edhe më e rëndë afër Pokrovskut dhe Kupjanskut, ku rusët bënë fitore taktike dhe më pas u zmbropsën nga forcat ukrainase. Cili është vlerësimi juaj për situatën aktuale?*

Frank Sobchak: Unë do ta shihja këtë më shumë nga një këndvështrim strategjik sesa taktik. Nga pikëpamja taktike, ajo që shohim është dy boksierë në ring duke shkëmbyer goditje. Pyetja strategjike është: Kush lodhet i pari? Kush dorëzohet dhe bie? Kjo lidhet me dy gjëra – industria e mbrojtjes dhe vullneti. Sa i përket vullnetit, të dyja palët mbeten jashtëzakonisht të forta. Nuk ka asgjë nga Rusia që të sugjerojë se kanë braktisur objektivat e tyre maksimaliste të luftës. Vendosmëria e Ukrainës gjithashtu mbetet e paprekur. Po, ka ndarje dhe çarje të të dyja palët, por asgjë vendimtare.

Në nivelin taktik, ne shohim një ngërc të ngjashëm me Luftën e Parë Botërore. Një pjesë shkaktohet nga ajo luftë e vullnetit, dy boksierët që ende shkëmbejnë goditje. Faktor tjetër i rëndësishëm që e bën frontin statik janë dronët. Në Luftën e Parë Botërore, kjo shkaktohej nga mitralozat, artileria dhe gazi helmues, sot kjo lidhet kryesisht me dronët. Ndikimi i tyre është i dyfishtë. Së pari, në inteligjencë, mbikëqyrje dhe zbulim: Tani çdo palë ka një pamje shumë më të qartë se çfarë po ndodh pas vijave të armikut, që është pamja më e qartë se në pothuajse çdo konflikt tjetër në të kaluarën.

Radio Evropa e Lirë: *Gjë që e bën më të vështirë befasinë taktike.*

Frank Sobchak: Absolutisht. Por, duke qenë se befasia tani është jashtëzakonisht më e vështirë, sa herë që njëra palë arrin ta realizojë, shpërblimet janë edhe më të mëdha. Ukrainasit e kanë treguar këtë gjatë ofensivës së tyre në Kursk, kur arritën të bënin befasia në nivel operacional, ndonëse jo surprizë strategjike. Faktor i dytë është se dronët janë

bërë, në shumë mënyra, fuqia ajrore e 'njeriut të varfër' – mbështetja ajrore e 'njeriut të varfër'. Ata kanë lejuar Ukrainën të arrijë diçka si barazi ajrore. Rusia nuk ka dominim ajror, ndryshe nga parashikimet e hershme të shumë analistëve perëndimorë. Dronët kanë krijuar barazi në fushëbetejë. Të dyja palët mund të kryejnë sulme efektive mbi këmbësorinë dhe mjetet e blinduara, duke e bërë pothuajse të pamundur përqendrimin masiv të trupave dhe avancimet e shpejta.

Radio Evropa e Lirë: *Pra, nuk pritet ndonjë përparim i madh në një të ardhme të afërt?*

Frank Sobchak: Ka pak gjasa të ndodh. Por, pasi kam studiuar historinë ushtarake që kur isha 10 vjeç, përshtypja ime është se luftërat si kjo zakonisht ecin shumë ngadalë, derisa papritmas përshpejtohen. Për t'u kthyer te metafora e boksit: kur një boksier lodhet tërësisht dhe nuk mund të mbrohet, atëherë vjen godita përfundimtare. Pasi çarjet që ne shohim tani të nisin të zgjerohen e të thyen, atëherë mund të shohim një kolapsim të shpejtë të njëres prej dy palëve – me kusht që lufta të zgjasë mjaftueshëm për të arritur deri në atë pikë.

Radio Evropa e Lirë: *Sa goditje e rëndë do të ishte nëse Rusia merr Pokrovskun? A do të përbënte një gjë e tillë përparim strategjik, ndoshta madje një goditje përfundimtare?*

Frank Sobchak: Nuk mendoj. Sigurisht që do t'i jepte Rusisë një avantazh taktik, por jo një avantazh vendimtar. Ideja se ata mund të shfrytëzojnë një përparim të tillë me sulme të mëdha më duket shumë e pamundur, vetëm nëse vetë ushtria ukrainase do të shkatërrohej dhe kjo nuk duket se do të ndodhë. Rezultati më i mundshëm, nëse rusët do të merrnin Pokrovskun, thjesht do të ishte një përparim taktik. Rusia nuk ka më kapacitet të madh manovrimi. Ata veçse kanë shpenzuar pjesën më të madhe të rezervave të tyre që datonin nga Lufta e Ftohtë. Furnizimi masiv i armatimit dhe makineri që më parë i lidhnim me forcat sovjetike, nuk është më. Thjesht nuk e kanë atë kapacitet, të paktën për momentin.

Edhe sikur disi ta arrinin këtë, ata nuk kanë trajnim për të zhvilluar luftë manovruese me armë të kombinuara. Kjo është një ndërmarrje shumë e ndërlikuar dhe kërkon trajnim e përgatitje të gjerë në të gjitha nivelet dhe udhëheqje në tërë zinxhirin komandues.

Radio Evropa e Lirë: *Dhe ky lloj i luftës manovruese në thelb është doktrinë e NATO-s, jo e Rusisë.*

Frank Sobchak: Pikërisht. Mënyra ruse e luftës është e kundërta e asaj amerikane. Mënyra amerikane është: dërgo një plumb, jo një njeri. Përdor



teknologjinë, artilerinë ose avionët për ta zgjidhur problemin. Mënyra ruse është: dërgo njerëz. Vazhdo furnizoji me njerëz derisa makineria të shkatërrohet. Kjo është arsyeja pse lufta manovruese në shkallë të gjerë është kaq e pamundur për ta dhe pse unë nuk shoh se mund të ndodhë një përparim operacional.

Radio Evropa e Lirë: *Kur flasim për ndikimin e madh të dronëve në këtë luftë, a mund të themi se ata kanë marrë kurorën nga artileria dhe janë bërë 'mbreti i fushëbetejës'?*

Frank Sobchak: Kjo është një pyetje me vend. Tradicionalisht, artileria është menduar në kuptim të masës: Ju mund të vendosni batalione, regjimente, kompani dhe të përdorni sasi të jashtëzakonshme të armëve në një zonë të vetme. Nëse shikon vetëm numrat e dronëve që tani po prodhohen brenda Ukrainës, aty padyshim ka 'masë' gjithashtu – megjithëse çdo goditje e një droni individual shpesh bart më pak fuqi shpërthyes sesa një predhë 152 ose 155-milimetërshe. Pra, në terma të pastër të fuqisë së zjarrit, artileria ndoshta ende e ka përparësinë. Por, ajo që po shohim në të vërtetë është një zhvendosje. Veçanërisht në anën e NATO-s. Ekzistonte një perceptim se artileria po evoluonte nga breshëritë masive drejt zjarrit preciz. Tani dronët po e mbushin atë boshllëk.

Radio Evropa e Lirë: *Një tjetër aspekt që shpesh diskutohet është ndikimi i artilerisë mbi forcat tokësore. Ndryshe nga ushtarët, një dron mund të rrëzohet, por ai nuk vuan nga traumat luftarake. Ai nuk pëson krizë nervore sepse raketat po bien nga qielli.*

Frank Sobchak: Absolutisht. Edhe dronët kanë mënyrën e tyre për të shkakuar terror psikologjik shkatërrues. Shiko videot ku rusët panikosen, vrapojnë për t'u fshehur, hidhen nëpër bunkerë – shpesh droni i parë thyen pozicionin, pastaj një tjetër fluturon pas ushtarëve. Është personale. Është ndjenjë e tmerrshme të ndiqesh në këtë mënyrë krahasuar me të qenët i ekspozuar ndaj zjarrit të artilerisë. Thënë këtë, edhe njerëzit që i

operojnë dronët mund të pësojnë trauma.

Radio Evropa e Lirë: *Nëse drejtimi dhe operimi gradualisht kalon në duart e inteligjencës artificiale – që duket se është dinamika e preferuar – a e zhvendos kjo balancën në favor të dronëve?*

Frank Sobchak: Po, sigurisht. Ne jemi në prag – nëse nuk kemi arritur tashmë – të një revolucioni në luftë, ku po shkohet drejt marrjes së drejtimit të dronëve nga inteligjenca artificiale (IA). Deri tani, nuk kemi parë dronë me kontroll të plotë nga inteligjenca artificiale, ku njeriu të jetë plotësisht jashtë procesit. Por, fjala kyç këtu është 'ende'. Ndërsa lufta vazhdon, ndërsa vendet bëhen më të dëshpëruara në këtë përballje, opsionet që dikur dukeshin të palejueshme e të pandërgjegjshme mund të fillojnë të duken si rruga më e mirë për t'u ndjekur.

Radio Evropa e Lirë: *Sa e ka lehtësuar përdorimi i dronëve mungesën e akute të ushtarëve që po përjeton Ukraina?*

Frank Sobchak: Dronët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm. Dronët janë bërë qendrorë për bazën e industrisë së mbrojtjes të Ukrainës. Madje flitet për prodhimin e deri në 1 milion dronëve në vit. Një shkallë e tillë do të ndihmonte absolutisht në kompensimin e mungesës së ushtarëve.

Radio Evropa e Lirë: *Po rusët? Sa mirë po përshtaten?*

Frank Sobchak: Rusët kanë treguar se përshtaten shumë mirë. Stereotipi i vjetër që i përshkruan Rusinë si një 'grirëse mishi' e stilit të Luftës së Parë ose të Dytë Botërore nënvlerëson aftësinë e tyre për inovacion dhe këtë po e shohim tani.

Në të njëjtën kohë, baza e tyre industriale është më e madhe. Shumë nga ajo që kemi parë nga kapacitetet e dronëve të Rusisë – veçanërisht sulmet ndaj qyteteve ukrainase, të cilat kanë qenë më të shpeshta kohët e fundit – janë mbështetur nga dronët iraniane, veçanërisht të llojit Shahed. Gjithnjë e më shumë, shumë prej tyre prodhohen brenda Rusisë. Ata gjithashtu kanë zhvilluar sistemet e tyre, si Rubicon, dhe po

rrisin prodhimin e dronëve për pengim. Ky mund të jetë një problem real për Ukrainën, përveç nëse ajo përshtatet më shumë dhe qëndron një hap përpara në garën e inovacionit. Pyetja strategjike është nëse aleatët e Rusisë do të vazhdojnë të rrisin mbështetjen. Koreja e Veriut ka dhënë miliona predha artilerie dhe dhjetëra mijëra ushtarë dhe ka raportime për më shumë ushtarë që po vijnë. A do të vazhdojë kjo? A do të vazhdojë Irani t'i furnizojë me të njëjtin volum, tani që ka shqetësime të tjera? Kjo mbetet e paqartë. Dhe sinqerisht, faktori më i madh mbetet ajo që bën SHBA-ja. Për ta thënë hapur, suksesi i Ukrainës varet nga SHBA-ja. Me gjysmën e ndihmës ushtarake të Ukrainës që vjen nga Amerika – nëse kjo ndihmë ndalet – do të krijonte një problem të thellë strategjik. Dhe, politika e SHBA-së që nga viti 2014 ka qenë, të themi, e paparashikueshme.

Radio Evropa e Lirë: *Le të flasim për marrëveshjen që presidenti amerikan, Donald Trump, arriti me NATO-n, pra që evropianët të blejnë armë nga SHBA-ja për t'ia dhënë më pas ato Ukrainës. A ka të njëjta kufizime si më parë? Për shembull, a mund të shohim raketa lundruese Tomahawk në një pako të tillë? Nëse gjithçka ka të bëjë me transaksione, jam i sigurt që NATO do të gjente disa arka të fshehura më parë për t'i hapur – me kusht që SHBA-ja të jetë e gatshme për t'i shitur.*

Frank Sobchak: Duket se përdorimi i NATO-s si një agjent për të blerë dhe më pas dorëzuar armë duket të jetë politika e re e SHBA-së. Nëse kjo do të ketë të njëjtat kufizime si më parë mbetet për t'u parë, por nëse do të duhet të hamendësoj, nuk mendoj se do të ndryshojë ndjeshëm ekuacionin. Po ashtu, mbetet e paqartë nëse Tomahawk-ët do të përfshihen, por unë do të thosha se nuk ka asnjë sistem armësh që do të ndryshonte rrjedhën në favor të njëres palë. Thelbi i konfliktit ka të bëjë me vullnetin kombëtar, bazën industriale të mbrojtjes dhe numrin e ushtarëve. Fitorja për njërën palë ose tjetrën do të vijë vetëm kur një nga këta 'boksierë' të rrëzohet i pari nga lodhja.

Radio Evropa e Lirë: *Dhe duket se as Ukraina nuk do të qëndrojë e ulur duke pritur. Kievi ka avancuar me prodhimin e vet të raketës së re Flamingo – një sistem që shumë thonë se është i krahasueshëm dhe, në disa aspekte, madje më i mirë se kundërshtari amerikan. Sa e rëndësishme mund të jetë kjo për balancën në fushëbetejë?*

Frank Sobchak: Edhe pse raketa e re Flamingo e Ukrainës padyshim është një inovacion taktik, unë do ta vendosja në të njëjtën kategori me raketat lundruese Tomahawk. Asnjë sistem armësh i vetëm nuk ka shumë gjasa të ndryshojë në mënyrë vendimtare balancën e fuqisë në favor të njëres palë. (REL)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Përfundon afati kalimtar në basketboll

Ka përfunduar afati kalimtar në basketboll të meshkujt dhe femrat. Afati kalimtar ka qenë mjaft i bujshëm me klubet që

janë përforcuar para edicionit të ri që pritet të jetë i zjarrtë. Të gjitha klubet janë përforcuar në bazë që

synimeve që kanë, duke bërë që të priten ndeshje interesante nga xhironja e parë në elitën e basketbollit të

Kosovës. Të gjitha klubet e ProCredit Superligës janë përforcuar, ashtu si edhe klubet e Superligës së

Femrave. Edhe elita e femrave pritet të jetë e zjarrtë me duele shumë sfiduese nga xhironja e parë e deri tek e fundit.

FODA: JETOJMË PËR FUTBOLLIN, SYNOJMË TA REALIZOJMË ËNDRRËN E BOTËRORIT

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Franco Foda, në ditën e parë të grumbullimit të shtatorit, ka mbajtur konferencën për media para dy ndeshjeve të para kualifikuese për Kampionatin Botëror 2026, që "Dardanët" do t'i zhvillojnë kundër Zvicrës më 5 shtator në Bazel dhe kundër Suedisë më 8 shtator në "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Foda ka theksuar se shorti e ka vendosur Kosovën në një grup të vështirë por, sipas tij, ekipi ynë ka cilësitë dhe potencialin për të synuar befasi. "Jemi në një grup shumë të vështirë. Zvicra dhe Suedia janë ekipe me shumë cilësi. Edhe Sllovenia, e cila u kualifikua herën e fundit në Evropian, ka një ekip shumë të mirë. Por, pavarësisht prej të gjithave, gjithçka është e mundur. Edhe ne kemi cilësitë dhe mundësitë tona. Vendi i parë kualifikohet direkt, ndërsa ekziston edhe mundësia që përmes 'play-off' -it të luftojmë për vendin e dytë. Ne luajmë futboll dhe jetojmë për futbollin. Ëndrrat bëhen realitet vetëm kur beson vërtet dhe je i bindur se mund të arrihesh. Këtë mesazh do t'ua përcjell edhe lojtarëve gjatë javës. E dimë që nuk është grup i lehtë dhe se jemi autsajder, por edhe një autsajder mund të jetë shumë i rrezikshëm. Ne do të japim gjithçka për vendin tonë, për Kosovën, që për herë të parë të kualifikohemi në Kupën e Botës", ka thënë Foda. Ai shtoi se atmosfera brenda grupit është pozitive. "Do të hyjmë në këtë sfidë me mendësi pozitive dhe do të shohim se ku do të na çojë ky rrugëtim. Po punojmë ngushtë me lojtarët dhe ata tashmë po tregojnë



drejtimin që duhet të ndjekim. Për ekipin kemi përgatitur edhe një video motivuese, të cilën do t'ua tregojmë sot dhe para ndeshjes. Shpresoj që kjo t'i motivojë edhe më shumë, sepse qëllimi ynë është i qartë: për herë të parë të kualifikohemi në një kompeticion të madh", ka theksuar Foda. Për shkak të lëndimit të Kosovës në këto dy ndeshje do t'i mungojë Florent Hadërgjonaj, i cili është zëvendësuar me Ron Račin, derisa për shkak të obligimeve të tij me transferimin të Juventusit mungon edhe Edon Zhegrova. Por Foda theksoi se ekipi është i gatshëm të përballet me çdo situatë. "Edon Zhegrova është një lojtar shumë i rëndësishëm për ne. Ai ka qenë i lënduar për tetë muaj dhe nuk ka luajtur. Kam biseduar disa herë me të gjatë javës së fundit. Javën e kaluar ishte për herë të parë në bankinë dhe ne i dërguam ftesë, por mbrëmë më njoftoi se do të

transferohet te Juventus, prandaj vendosëm që të mos bashkohet me ne këtë herë. Po ashtu, Emir Sahiti dhe Bersant Celina i dinë arsyet e mungesës së tyre. Do të bisedoj sërish me ta dhe pastaj do të flasim edhe publikisht për këtë. Jemi në kërkim të zgjedhjeve të reja dhe në të kaluarën kemi treguar se jemi të gatshëm të përballojmë çdo mungesë. Jemi shumë optimistë që edhe në këto dy ndeshje do t'ia dalim dhe do të arrijmë rezultat pozitiv", ka nënvizuar Foda. Përzgjedhësi është shprehur i lumtur për vendimin e Leon Avdullahut për ta zgjedhur Kosovën. "Jemi të gëzuar dhe shumë të lumtur që Leon Avdullahu ka vendosur të luajë për Kosovën. Ai ka kaluar te Hoffenheimi nga Bazeli dhe është integruar shpejt në Bundesligë. Është lojtar fleksibil dhe mund të luajë në disa pozita", ka përfunduar Foda.

Shkurt

Lyoni interesohet për Rrahmanin

Sulmuesi Albion Rrahmani mund të ndryshojë ambient në orët e fundit të afatit kalimtar. Lëvizje të shumta pritet të ndodhin në ditën e fundit të afatit kalimtar veror, ku këtu nuk përjashtohen as disa lëvizje të futbollistëve kosovarë nëpër Evropë. Gazetari i njohur Santi Aouna ka raportuar se gjiganti francez Lyon ka shprehur interesim për transferimin e Rrahmanit. Sipas Aounas, Lyoni ka ofruar gjashtë milionë euro për t'i siguruar shërbimet e Rrahmanit, por Sparta Praha po kërkon tetë milionë. Negociatat mes dy klubeve pritet që të vijojnë në vazhdim pasi oferta e Lyonit dhe kërkesa e klubit çek nuk ka një dallim të madh. Kujtojmë se Rrahmani e ka nisur furishëm edicionin e ri në elitën e futbollit çek, duke realizuar pesë gola pas shtatë ndeshjeve të luajtura.

Ballkani konfirmon transferimin e Adetunjit tek Al Hilali

FC Ballkani ka njoftuar zyrtarisht shitjen e sulmuesit nigerian Sunday Adetunji te klubi sudanez Al Hilal. Kishte kohë që Adetunji kërkonte largimin nga klubi, duke mos pranuar të luante në ndeshjet e fundit. "Në bashkëpunim me Al Hilalin nga Sudani kemi arritur marrëveshje për transferimin e Adetunjit. Sulmuesi ynë mbyll kapitullin te FC Ballkani dhe i urojmë shumë suksese në aventurën e re në karrierë", thuhet në njoftimin e klubit. Gjatë kohës së tij te Ballkani, Adetunji luajti 38 ndeshje, ku shënoi 22 gola dhe regjistroi 7 asistime. Në garat evropiane të këtij viti sulmuesi afrikan realizoi 4 gola për ekipin kosovar, duke qenë një nga figurat kyçe të skuadrës në arritjen e objekti-vave të saj.

Egzon Belica rikthehet te Shkëndija

Shkëndija e Tetovës ka zyrtarizuar afrimin e mbrojtësit me përvojë Egzon Belica. 34-vjeçari nga Struga rikthehet te kuqezinjtë pas gati një dekade, pasi më parë kishte veshur fanellën e Shkëndijës në sezonin 2014/15. Belica luan në qendër të mbrojtjes dhe pas vetes ka një karrierë të pasur ndërkombëtare. Në futbollin shqiptar ka mbrojtur ngjyrat e Besës së Kavajës dhe Partizanit të Tiranës, ndërsa në Kosovë ishte pjesë e Prishtinës. Ai ka provuar kampionate të ndryshme evropiane: në Rumani me Concordia, në Finlandë me Inter Turku, në Letoni me Riga, kurse para se t'i bashkohej Shkëndijës ishte pjesë e Rabotniçkit në Shkup. Me rikthimin e Belicës kuqezinjtë përfitojnë një lojtar me përvojë të madhe dhe lidërsip në repartin e mbrojtjes, i cili pritet të jetë një shtyllë e rëndësishme për sfidat në kampionat dhe në Ligën e Konferencës.

Zvicra nuk shqetësohet për Hajdarin

Drejtori i Kombëtares së Zvicrës, Pierluigi Tami, ka thënë se nuk është i brengosur për Alban Hajdarin. Ai ka debutuar për Zvicrën, ndërsa së fundi e ka

lënë të hapur derën për Kosovën dhe ka pasur një takim me kreun e FFK-së, Agim Ademi. Megjithatë, edhe dera e Zvicrës është e hapur për Hajdarin.

"Nuk jam i brengosur. Dera është e hapur. Ai tashmë ka luajtur miqësore me ne dhe ishte parashikuar të luante në ndeshje garuese. Ai ende mund

të lëvizë sipas rregullave, por nuk jam i brengosur. Murat Yakin ka bërë shumë dhe do të fillojmë të planifikojmë për të menjëherë pas kësaj lëvizjeje",

ka thënë Tami në konferencë për shtyp të hënën. Hajdari së fundmi është transferuar te skuadra e Hoffenheimit në Bundesligën e Gjermanisë.

Mercedesi vazhdon me dyshen e pilotëve Russell - Antonelli

SHTUTTGART, 1 SHTATOR - “Mercedes”-i do të vazhdojë me George Russell dhe Kimi Antonellin si pilotë të skuadrës në Formula 1 në vitin 2026, konfirmoi drejtuesi i skuadrës, Toto Wolff, pas Çmimit të Madh të Holandës. “Gjithmonë them se nuk do të ketë ndonjë lajm të madh sepse thjesht po bëjmë atë që duhet. Po vazhdojmë me të dy, sigurisht. Me George ka disa gjëra që duam t’i

optimizojmë sa iu përket udhëtimeve dhe ditëve të marketingut. Ai është një pilot me eksperiencë dhe për ne është gjithmonë e rëndësishme ta diskutojmë”, ka thënë ai duke iu referuar faktit që kontrata e britanikut Russel ende nuk është konfirmuar. Risia e madhe është vazhdimi i besimit tek italianit 19-vjeçar Kimi Antonelli, i cili pati një fundjavë të vështirë në Zandvoort, duke u

penalizuar për përplasjen me Charles Leclerc dhe për shpejtësi në bokse. Por Wolff nuk ka asnjë dyshim për potencialin e italianit 19-vjeçar. “I dhamë një vit mësimi, me momente të vështira e të tjera brilante. Besimi im 100 % është tek ai në planin afatgjatë”, ka deklaruar ai. Në fillim të gushtit, Max Verstappen konfirmoi qëndrimin te Red Bulli, duke i


mbyllur derën një kalimi te Mercedes. Për këtë arsye, skuadra shtyu bisedimet me Russelin derisa u sqarua e ardhmja e katër herë kampionit. Wolff bëri me dije gjithashtu se skuadra po vlerëson kërkesat jashtë pistës ndaj pilotëve, duke reduktuar ngarkesën me aktivitete marketingu dhe medie. “Duam ta kemi performancën më të mirë të tyre dhe mendoj se i kemi ngarkuar



mjaft me aktivitete marketingu dhe medie. Kjo është ajo që po rikalibrojmë”, ka thënë ai, duke shtuar se nuk pritet një deklaratë zyrtare e menjëhershme për përbërjen e ekipit të vitit 2026.

Avdullahu zbarkon në Prishtinë: Kosova zgjedhje zemre, shpresojmë të fitojmë ndaj Zvicrës

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Futbollisti Leon Avdullahu ka zbarkuar në Prishtinë, ku do ta nisë grumbullimin me Kombëtaren e Kosovës. Në Aeroportin “Adem Jashari” për ta pritur atë kishte dalë presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Mesfushori kosovar që luan te Hoffenheimi në Bundesliga është shprehur shumë i lumtur që ka marrë vendim për ta refuzuar Zvicrën dhe ta zgjedhë Kombëtaren e Kosovës. “Jam shumë i kënaqur. E kam marrë vendimin me zemër dhe jam shumë i lumtur që e kam marrë këtë vendim dhe shpresoj të arrij gjëra të mëdha me Kosovën. Më ka pëlqyer edhe projekti sportiv dhe



për këtë e kam pasur më të lehtë të vendosi. Personalisht nuk i njoh lojtarët e Kosovës, veç Fisnikun (Asllanin), ata të tjerët jo”, ka thënë Avdullahu. Avdullahu shpreson në fitore ndaj

Zvicrës dhe se do të japë maksimumin me fanellën dardane. “Shpresojmë që të fitojmë, që ta bëjmë një lojë të mirë. E dimë që Zvicra është favorite, por edhe ne e kemi ekipin e mirë, kështu që do të jetë një lojë e fortë. Do ta jap çdo herë maksimumin për Kosovën. Ishte një zgjedhje e zemrës, edhe më bindi projekti”, ka pohuar Avdullahu. Krejt në fund mesfushori dardan tha se shpreson që edhe Albion Hajdari të vijë te Kosova. “Shpresoj që edhe Albioni (Hajdari) të vijë te Kosova, por ai do të vendosë vetë. Sa i përket kualifikimit, çdo gjë është e mundur. Jam pozitiv çdoherë”, ka pohuar Avdullahu.

Kosova për herë të parë në tavolinën më të lartë vendimmarrëse të parasportit në Evropë

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Në një garë të fortë mes shteteve anëtare të Komitetit Paralimpik Evropian, Njomza Emini, presidente e Komitetit Paralimpik të Kosovës, është zgjedhur anëtare e Bordit Ekzekutiv të Komitetit Paralimpik Evropian për mandatin 2025-2029. Votimi i Eminin u bë në Asamblenë e Përgjithshme të EPC-së, të mbajtur më 30 gusht në Londër, ku morën pjesë 45 shtete anëtare nga gjithë kontinenti. Sipas një komunikate për medie, Emini rezultoi më e votuara në mesin e shteteve pjesëmarrëse, me një sukses të jashtëzakonshëm diplomatik, duke lënë pas në këtë votim përfaqësues nga vende si Britania e Madhe, Serbia, Izraeli e të tjera. Në këtë mbledhje, presidenti i EPC-së u rizgjodh holandezi Raymon Blondel, i cili në prill të këtij viti, me ftesë të presidentes Emini, vizitoi Kosovën. “Teksa bëhen dy vjet nga pranimi i Kosovës në Komitetin Paralimpik Evropian, ne jemi tashmë edhe pjesë e organit më të



lartë ekzekutiv të kësaj instance. Për mua është ndjenjë e jashtëzakonshme që të marr besimin e homologëve të mi dhe të dal si më e votuara në këtë konkurrencë”, ka thënë Emini. Ajo u shpreh e lumtur që, përmes saj, parasporti kosovar do të ketë edhe më tepër zë dhe hapësirë për zhvillim. Kjo është hera e parë në histori që Kosova përfaqësohet në strukturën më të lartë drejtuese të parasportit evropian dhe një nga arritjet më të rëndësishme për vendin në arenën ndërkombëtare sportive. Emini udhëheq Komitetin

Paralimpik të Kosovës që nga viti 2011, duke kontribuar në çdo hallkë të zhvillimit të parasportit në vend, që nga strukturimi i parë institucional, te përfaqësimet ndërkombëtare dhe, së fundmi, pjesëmarrjen historike të Kosovës në Lojërat Paralimpike “Paris 2024”. Për Komitetin Paralimpik të Kosovës kjo nuk është vetëm një fitore për përfaqësim, është hapja e një epoke të re të ndikimit, bashkëpunimit dhe fuqizimit të zërit të parasportistëve të Kosovës, në një tavolinë ku deri dy vjet më parë vendi nuk kishte as ulëse.

SHKURT

Asllani pas debutimit me Torinon: Mund të shkojmë larg

Mesfushori Kristjan Asllani është shprehur i lumtur me debutimin e tij te skuadra e Torinos. Asllani ishte titullar në barazimin e Torinos pa gola ndaj Fiorentinas të dielën mbrëma dhe u aktivizua deri në minutën e 80. 23-vjeçari javën e shkuar u transferua te Torino nga Interi dhe te skuadra e re pritet të ketë një rol të rëndësishëm në mesfushë. “Mezi prisja të luaja me këtë fanellë dhe besimin e trajnerit do të përpiqem ta shpërblej në çdo mënyrë. Kemi ekip të mirë dhe mund të shkojmë larg”, është shprehur Asllani. Futbollisti i Shqipërisë tha se ndihet krenar që te Torino do të ketë më shumë përgjegjësi sesa tek Interi.

Leverkuseni shkarkon Ten Hagenin

Karriera e Erik ten Hag te Bayer Leverkuseni përfundon papritur, pas vetëm dy ndeshjeve në Bundesliga (2025-2026). Shkak u bë barazimi 3-3 ndaj Werder Bremenit, që luante me 10 lojtarë, teksa Leverkuseni shpërdoroi avantazhin 3-1, duke pësuar kolapsin e papritur. Pas kësaj ndeshjeje si shkak, drejtuesit e klubit vendosën të ndahen me trajnerin holandez, i cili drejtoi vetëm dy ndeshje zyrtare në kampionat. Në një komunikatë zyrtare Leverkuseni ka njoftuar: “Bayer 04 Leverkusen ka vendosur të ndahet menjëherë me trajnerin Erik ten Hag. Deri në një vendim tjetër, stërvitjet do të udhëhiqen nga stafi ndihmës i trajnerit”. Ky është një lajm befasues, duke pasur parasysh reputacionin e Ten Hag si ish-trajner i Manchester Unitedit, por tregon presionin e madh në Bundesliga dhe pritshmëritë e larta për skuadrën gjermane në fjalë.

Hamiltoni penalizohet me pesë pozicione për garën e Monzës

Gjithçka ka shkuar keq për pilotin britanik Lewis Hamilton dhe Ferrarin në garën e fundit në Holandë. Sikur të mos mjaftonte aksidenti në pistën e Zandvoort, komisarët e garës i dhanë 7 herë kampionit të botës në Formula 1 një dënim të ashpër. Britaniku do të vuajë një penalizim prej pesë vendesh në garën e ardhshme të Formula 1, atë që do të zhvillohet në Monza (Itali). Hamiltoni ishte nën hetim për mosrespektimin e flamujve të dyfishtë të verdhë gjatë xhirove të kontrollit para garës. Dokumenti zyrtar i lëshuar nga FIA shpjegon në detaje se çfarë ndodhi: Flamuri i dyfishtë i verdhë në kthesën e fundit ishte një procedurë që ishte njoftuar tashmë nga drejtuesit e garës duke pasur parasysh natyrën unike të pistës Zandvoort e cila është jashtëzakonisht e ngushtë.

Neymari përgënjeshtroi Ancelottin që nuk e thirri në kombëtare

Periudha inauguruese e Carlo Ancelottit si trajner i Brazilit ka hasur “turbulencat” e para. Pas barazimit 0-0 ndaj Fluminense, Neymari foli rreth mungesës së tij në listë për ndeshjet kundër Kilit dhe

Bolivisë. Ylli brazilian u shpreh se vendimi i trajnerit italian ishte “teknik” dhe nuk kishte lidhje me gjendjen e tij fizike. Megjithatë, versioni i Ancelottit ishte ndryshe. Në momentin e shpalljes së listës

italiani theksoi se Neymari kishte pasur një problem të vogël fizik, ndaj nuk kishte arsye të rrezikohej në këto sfida, pasi Brazili tashmë është i kualifikuar për Botërorin 2026. Ky

interpretim i ndryshëm mes lojtarit dhe trajnerit ka ndezur diskutime në medie, duke shtuar presionin mbi Ancelottin në fillimin e aventurës së tij me “Seleção”. Neymari, i cili

mbetet një nga figurat më të rëndësishme të kombëtares braziliane, duhet të rikthehet në 100 % të formës për të qenë pjesë e kompeticionit më të madh, Botërorit të vitit të ardhshëm.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Blerta Deva” B.I. - D.P.T. “Calypso” me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811134923 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitore në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti "Blerta Deva" B.I. - D.P.T. "Calypso" Jakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811134923 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that “Blerta Deva” B.I. - D.P.T. “Calypso” with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 811134923 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Albrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gadaf Fetahu shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Halis Ademi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Qendresa Kastrati shpall te pavlefshme dëftesën e kl V- IX shfmu "Brigada 125" Medvec
- Burim Buza shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

